

**08**

# **BULETINI I RIMËKËMBJES**

maj 2021

**8%**

**DELETED**

**Ulja e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar  
nga 18% në 8%.**

# Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) vazhdon të informojë qytetarët e Kosovës rreth zhvillimeve dhe të rejave të Pakos së Rimëkëmbjes përmes publikimit periodik të Buletineve të Rimëkëmbjes, raporteve dhe infografkave. Këto publikime kanë për qëllim që përmes informatave që i ofrojmë qytetarëve të Kosovës, me një gjuhë dhe terminologji sa më të thjeshtë të i shpalosë elementet kryesore të Ligjit të Rimëkëmbjes dhe Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike për pandeminë COVID-19. Kjo në mënyrë që çdoherë e më shumë të rritet transparenca dhe llogaridhënia ndaj qytetarëve të Kosovës.

Edicioni i rradhës i Buletinit e shpalosë temën e uljes së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar nga 18% sa ishte në 8%. Kjo ulje vlenë për furnizimet e hoteleve, restoranteve dhe shërbimet e ushqimit. Në kuadër të këtij buletini, INDEP jep informata edhe për shkallën e zbatimit të kësaj mase. Gjithashtu bë këtë Buletin diskutohet edhe për masat të cilat nuk kanë gjetur zbatim ende, sidhe ato masa të cilat tash së voni kanë filluar zbatimin.

# 8%

**DELETED**

## Zbatimi i Pakos së Rimëkëmbjes dhe sektori i gastronomisë

Pakoja për Rimëkëmbje Ekonomike ka plotësuar tashmë 6- mujorin e parë që nga fillimi i zbatimit të masave të përcaktuara përmes Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Edhe pse jo të gjitha masat filluan zbatimin e tyre ashtu siç ishin të parapara me ligj, masa e përcaktuar përmes nenit 7 mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar ka gjetur zbatim që nga fillimi. Kjo masë ka hyrë në fuqi në muajin dhjetor, 2020 dhe do vazhdojë të zbatohet deri në fund të vitit 2021.

Sektori i gastronomisë, përfshirë këtu hotelet, restorantet dhe shërbimet e tjera të ushqimit janë ndër sektorët e prekur nga pandemia COVID-19. Qeveria e Kosovës përmes nenit 7 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, rregulloi masën e cila do ndihmonte në rimëkëmbjen e këtij sektori të cilit sikurse edhe shumë sektoreve tjera të ekonomisë së vendit i janë shkaktuar dëme të mëdha. Zbatimi i kësaj mase pritet që deri në fund të vitit 2021 të ketë impakt në rimëkëmbje të këtyre sektorëve.

Me miratimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike është plotësuar dhe ndryshuar edhe Ligji Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Përmes nenit 7 të Ligjit Nr. 05/L-016 për Rimëkëmbje Ekonomike i cili e plotëson dhe e ndryshon nenin 26 të Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, theksohet së uljes së TVSH-së i bashkëngjiten edhe furnizimi i hoteleve, restoranteve dhe shërbimeve të ushqimit. Kjo ulje është nga 18% në 8%.

### Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Neni 26 i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (LTVSH), pas nën-paragrafit

2.13 shtohet një nën-paragraf i ri, me numër rendor 2.14., me tekstin si në vijim:

2.14. furnizimet e hoteleve, restoranteve Dhe shërbimet e ushqimit.

## Kush përfiton nga kjo masë?


Të drejtë e shfrytëzimit të aplikimit të uljes së TVSH-së e kanë të gjithë personat të cilët janë të regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe paguajnë tatime për furnizime të mallërave dhe shërbimeve hoteliere, restorantet dhe shërbimet e ushqimit.

Pra të drejtë zbatimi të uljes së TVSH-së kanë të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët janë të regjistruar për pagesat mbi TVSH dhe që këto blerje të mallërave dhe shërbimeve i shfrytëzojnë për qëllim të realizimit të furnizimeve hoteliere, restoranteve dhe shërbimeve të ushqimit. Ky vendim ka hyrë në fuqi që nga data 07.12.2020 dhe do vazhdojë të zbatohet deri më 31.12.2021<sup>1</sup>



Në mënyrë që zbatimi i kësaj mase të jetë gjithëpërfshirës dhe i rregullt, të dhënat rreth bizneseve që operojnë në Kosovë janë të marr nga ASK. Këto të dhëna përgatiten nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). ASK përmbanë informacione rreth të gjitha bizneset të cilat janë të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK). Këto biznese janë biznese që ushtrojnë aktivitete ekonomike brenda Kosovës.

Prandaj, ASK në kuadër të kësaj teme, ka pjesë përbërëse edhe Regjistrin Statistikor të Bizneseve. Ky Regjistër përmbanë informata të përgjithshme për të gjitha bizneset që janë aktive brenda Kosovës dhe si i tillë, përmes këtij regjistri qytetarët e Kosovës mund të shëbehen me të përmes analizave statistikore dhe demografike të bizneseve duke ndihmuar kështu si resurs primar në llogaritjen e Bruto Produktit Vendor.



<sup>1</sup> Administrata Tatimore e Kosovës, Vendim shpjegues publik Nr.-01.2020, (2020), e qasshme në: <https://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2020/12/Vendim-shpjegues-publik-Nr.-01.2020.pdf> (e qasur më prill, 2021)

Informatat e marra nga Raporti Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike për TM1, 2021, vetëm gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 (TM1, 2021), janë regjistruar 2491 ndërmarrje . Ky numër i ndërmarrjeve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka një ngritje për 27.26% të bizneseve të regjistruara. Gjithashtu, nëse e krahasojmë këtë trend të rritjes me tremujorin e fundit të viti 2020, atëherë dallojmë një ngritje prej 2.54%.




Sa i përket aktiviteteve të cilat janë dalluar për nga regjistrimi i ndërmarrjeve, përfshihen: tregtia me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 804 (27.33%), prodhim me 344 (11.69%), ndërtimtaria me 340 (11.56%), akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 293 (9.96%), aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 293 (9.96%), Informacion dhe komunikim me 173 (5.88%). Këto fusha krahasuar me fushat e periudha të njëjta të vitit të kaluar, shënojnë ngritje. Kjo dallohet edhe në fushën të cilën përfshihen shërbimet e furnizimeve të hoteleve, restoranteve dhe shërbimet e ushqimit, të cilat futen në kategorinë e akomodimit dhe aktiviteteve dhe shërbimeve me ushqim. Në këtë sektor, dallohet një ngritje prej 11.7% për dallim nga viti i kaluar.

## Raporti Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike





<sup>2</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë TM1 2021, (2021), e qasshme në: <https://ask.rks.gov.net/media/5990/rep-stat-tm1-2021.pdf> (e qasur më prill, 2021)

## Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori



## Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori



Efektet e pandemisë në sektorin privat janë të mëdha. Këto efekte dallohen edhe në rënien e zhvillimit ekonomik që e pësoi vendi ynë gjatë kësaj periudhe. Mirëpo kjo gjendje e shkaktuar në të gjithë botën ka filluar që të i rikthehet gjendjes normale. Këtë e tregojnë edhe të dhënat statistikore të publikuara nga Agjencia Statistike e Kosovës .

## Masat që nuk gjetën ende zbatim

Masat e përcaktuara përmes Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike kanë gjetur zbatim në ekonominë e vendit. Mirëpo jo të gjitha masat e përfshira në këtë pako u zbatuan. Kjo më së shumti dallohet tek dy masat të cilat ende nuk janë vënë në zbatim e që nuk janë përfshirë as në buxhetin e miratuar për vitin 2021. Kjo pritet të jetë një sfidë për bizneset dhe qytetarët të cilët kanë humbur vendet e tyre të punës gjatë periudhës së pandemisë ose që janë pezulluar nga vendet e tyre të punës.<sup>3</sup>

Përkrahja e ndërmarrjeve private (bizneseve) të prekura nga pandemia është paraparë përmes mbështetjes financiarisht nga ana e buxhetit të Republikës së Kosovës me mjete financiare të buxhetit të Kosovës prej dyqind milion euro (200,000,000 euro). Shuma prej 200 milion euro lëre që nuk është zbatuar, por nuk është paraparë as në planifikimin e buxhetit për vitin 2021. Për komplet Pakon e Rimëkëmbjes janë paraparë 222.4 milion euro! Prandaj, 200 milionëshi për mbështetje të sektorit privat, nga buxheti aktual, nuk pritet të zbatohet as në vitin 2021.



**300€  
PËR  
3 MUAJ**

Ngjashëm me këtë kemi edhe masën rreth pagesave të pagave të punëtorëve. Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, këto paga do të iu paguheshin të gjithë punëtorëve të sektorit privat për periudhën tetor-dhjetor 2020, të cilët si pasojë e pandemisë janë larguar apo pezulluar nga puna për jo më pak se 3 muaj, pas datës 29 shkurt 2020, deri më 30 dhjetor 2020. Shuma e pagesës për këta punëtorët nga ishte paraparë që të ishte nga 300 euro për tre muaj.

<sup>3</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë TM1 2021, (2021), e qasshme në: <https://ask.rks-gov.net/add-news/buletini-tremujor-tm1-2021/> (e qasur më prill, 2020)



08

# BULETINI I RIMËKËMBJES

maj 2021



Ky buletin është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit të Kosovës për shoqëri të Hapur (KFOS). Pikëpamjet e shprehura në këtë buletin janë INDEP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të hapur (KFOS).